Co-PLAN GAZETTE

Publikim Gjashtëmujor i Co-PLAN, Instituti Për Zhvillimin e Habitatit - Gazeta Nr.6 Shkurt 2014



Reforma territoriale

Rëndësia e dimensioneve që shkojnë përtej aspektit fizik të diskutimit mbi Reformën Territoriale - Administrative në Shqipëri; roli dhe kompetencat e *Qarkut* pas reformës, etj. ***(fq. 1-5)***



Efiçenca Energjitike

Konkluzione e gjetje me rëndësi nga takimi i organizuar nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, në bashkëpunim me disa Shoqatat Mjedisore mbi Efiçencën Energjitike.***(fq. 6-7)***



TDW & Arti Urban

Mësime të vlefshme mbi Artin Urban si mjet për ndryshim dhe disa nga ndërhyrjet urbane më të spikatura të Javëve të Dizajnit në Tiranë organizuar në Shtator-Tetor 2013 në Universitetin POLIS. ***(fq. 8-9)***



Qyteti TROÇ

Episode absurdi, humori, dhe eksperiencash urbane të shkëputura nga jeta e përditshme në shumë nga qytetet tona, të para nga lente të ndryshme. ***(Suplement)***

Reforma Territoriale përtej dimensionit fizik

Vitet 90të - Decentralizimi i qeverisjes në Shqipëri nis në fillim të viteve '90të, kur qeveritë vendore për herë të parë u zgjodhën në mënyrë demokratike. Pavarësisht se nuk mund të flasim ende për autonomi administrative apo fiskale, reformat e vitit '92 vendosën bazën për krijimin e autoriteteve vendore demokratike, të cilat ngadalë u përgatitën për të marrë më tepër përgjegjësi e funksione. Ratifikimi pa kushte i Kartës Europianë të Vetëqeverisjes Vendore (8548/1998) dhe miratimi i Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore (8652/2000) shënojnë momentin e dytë të rëndësishëm në decentralizimin e qeverisjes, duke krijuar kornizën për decentralizimin e plotë administrativ e fiskal. Të dyja këto dokumente përcaktojnë si një prej objektivave kryesore të reformave të decentralizimit në Shqipëri, *nevojën që Njësitë e Qeverisjes Vendore duhet të jenë të afta të ofrojnë funksionet e transferuara tek qytetarët.*

Viti 2000 - Për këtë arsye, si pjesë e reformave të decentralizimit të qeverisjes u miratua edhe Ligji për ndarjen Administrative Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore (8653/2000). Në thelb, ndarja administrative e vitit 2000, përpiqet të ruajë kufijtë historikë të bashkive, komunave, rretheve apo prefekturave (duke iu referuar fillim shekullit të XX) duke shkrirë kufijtë administrativë të (36) rretheve me ato të qarqeve.

Kjo paketë reformash, që përcaktoi kornizën kryesore të decentralizimit të qeverisjes në Shqipëri, u ndërtua mbi supozimin (nuk mund të themi se u artikulua në formën e objektivit strategjik) se njësitë e qeverisjes vendore, të cilat nuk do të kishin mundësi për të ofruar më vete funksionet dhe përgjegjësitë e transferuara, do të përdornin alternativën e ofruar prej Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (8417/1998) dhe Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore për t'u bashkuar me njëra tjetrën, apo për t'u angazhuar në bashkëpunime ndërvendore.

Mbi këtë supozim u përgatitën edhe ligjet dhe udhëzimet që plotësuan kornizën e decentralizimit fiskal dhe administrativ, e u konceptuan dhe hartuan transfertat ndërqeveritare dhe grantet deri në vitin 2006. Megjithatë,

1990 — 1998 — 2000 — 2003 — 2004 — 2005



Burimi: Co-PLAN bazuar në kufinjtë zyrtarë të baseneve ujore.

Si mund të arrihet rajonalizim - Qasja 1

Në këtë qasje të mundshme kufinjtë 'rajon' janë shënuar me ngjyrë blu. Sipas kësaj qasjeje, ndarja është në 6 rajone, bazuar në basenet ujore të lumenjve kryesorë në Shqipëri, përkatësisht ai i lumit të Drinit, Matit, Erzen - Ishmit, Shkumbinit, Semanit, e Vjosës.

Instituti për Kërkim dhe Zhvillim - IKZH_POLIS

© Kjo gazetë, përfshirë dhe imazhet nuk mund të riprodhohen, pjesërisht apo tërësisht, pa pëlqimin e autorëve dhe Co-PLAN.

Reforma Decentralizimi Fiskal *(vazhdim)*

me përjashtim të ndonjë rasti[1], bashkimi vullnetar nuk ndodhi.

Viti 2003 - Në këto kushte, në vitin 2003 u rimor diskutimi mbi reformën administrativo territoriale, dhe referuar një dokumenti politik përgatitur prej Këshillit të Europës, në vitin 2004 u hartua një draft ligj për riorganizimin territorialo administrativ të vendit. Draft ligji përcakton një sërë kriteresh, që në thelb synojnë plotësimin e objektivit të sipër-përmendur për njësi të qeverisjes vendore të afta të gjenerojnë të ardhura dhe të ofrojnë në mënyrë efiçente funksionet e përcaktuara nga ligji. Draft ligji nuk gjeti konsensusin politik dhe si i tillë nuk u miratua nga parlamenti.

Viti 2005 - shënon një tjetër moment të rëndësishën në procesin e decentralizimit të qeverisjes, dhe me ndryshimin e qeverisë ndryshon edhe qasja strategjike në procesin e decentralizimit fiskal. Sistemi i transfertave ndërqeveritare e granteve u reformua, duke prezantuar ekualizimin thuajse të plotë fiskal si instrumentin që do të zgjidhte problemin e njësive të vogla dhe shumë të vogla vendore për të gjeneruar të ardhura dhe ofruar shërbime për qytetarët. Kjo qasje, e arsyetuar me ruajtjen dhe përmirësimin e demokratizimit të qeverisjes, krijoi në fakt konfuzion në lidhje me atë që përcaktohej në strategjinë e decentralizimit si *qeverisje e mirë dhe efektive.*

Dimensione të rëndësishme për t'u konsideruar si pjesë e Reformës Territoriale

Në të vërtetë, dilema për krijimin e njësive më të mëdha vendore, që ofrojnë shërbime në mënyrë më efiçiente e përdorin më mirë burimet financiare dhe i përgjigjen nevojës së përfaqësimit më pranë qytetarit (demokratizimi i qeverisjes), përbën temën kryesore mbi të cilën është përqëndruar diskutimi i deritanishëm. Por, janë në fakt edhe një sërë çështjesh të tjera, të cilat do të duhet të adresohen nëpërmjet reformës territoriale administrative:

(i) fragmentarizimi i lartë i vendit - 10% e popullsisë jetojnë në 41% të **NJQV** me më pak se 5'000 banorë – rezulton me kosto tepër të lartë të ofrimit të shërbimeve bazë për qytetarët;

(ii) kapacitetet e kufizuara njerëzore, me të cilat përballen shpesh njësitë e vogla vendore, e si rezultat pamundësia për të ushtruar funksionet vendore, gjeneruar e grumbulluar të ardhura e ofruar shërbime;

(iii) procesi i lënë përgjysëm i decentralizimit administrativ e fiskal, deri diku prej kapaciteteve të ulëta vendore, por edhe prej nderhyrjeve të shpeshta e kaotike në bazën ligjore, reduktimit të autonomisë fiskale dhe mos mbulimit financiar të mandateve për funksionet e përbashkëta;

(iv) roli i paqartë i qarqeve (njësi vendore të nivelit të dytë) si koordinuese e mbështetëse në ushtrimin e funksioneve vendore;

(v) nevoja për një politikë të brendshme të zhvillimit rajonal që përputhet me kërkesat e integrimit në BE dhe me nevojën për qeverisje në shumë nivele, përfshirë atë rajonale; etj.

2014

të Europës në vitin 2003, Banka Botërore ndërmerr një vlerësim të thellë të Decentralizimit të Qeverisjes në Shqipëri dhe propozon një sërë reformash në lidhje me decentralizimin administrativ e fiskal si dhe reformën territoriale, ku mes të tjerash spikat rekomandimi për shpërndarjen asimetrike të funksioneve dhe përgjegjësive të **NJQV**-ve referuar kapaciteteve njerëzore dhe fiskale.

OSBE, **PNUD** dhe **SIPU** në vitet 2005–2010 risjellin në vëmendje nevojën për reformën administrativo-territoriale, duke e lidhur atë me zhvillimin rajonal dhe krijimin e rajoneve ekonomike, duke e konsideruar këtë edhe si një prej parakushteve në procesin e integrimit në **BE**.

PLGP/USAID, së fundmi risjell në vëmendje nevojën për reformën administrative duke e lidhur atë

Efiçienca në ofrimin e shërbimeve për qytetarët



Burimi: Ministria e Financave 2011, Co-PLAN

Një sërë projektesh, donatorësh, aktorësh lokalë kanë ushqyer e në disa raste edhe filluar diskutimin në lidhje me reformën territoriale administrative, apo decentralizimin administrativ e fiskal të qeverisjes[2].

Kështu, pas Sekretariatit të Këshillit ngushtësisht me përmirësimin e decetralizimit në qeverisje dhe përmirësimin në ofrimin e shërbimeve vendore. Vëmendja tërhiqet në mënyrë të veçantë në lidhje me ndikimin negativ të reformave të ndëtrmarra në

1 Në vitin 2003 komuna e Barbullushit dhe ajo e Bushatit në Qarkun e Shkodrës u bashkuan në një njësi vendore, Komunën e Bushatit (9123/2003)

2. KE (2003); WB (2004); OSCE (2006); UNDP (2010); SIPU (2006); USAID (2012); SDC&ADA (2012).





40 NJQV shpenzojnë mbi **80%** të buxhetit të tyre për pagat e punonjësve.

230 NJQV shpenzojnë mbi **60%** të buxhetit të tyre për pagat e punonjësve.

63% e NJQV-ve që përfaqësojnë **34%** të popullsisë shpenzojnë mbi **60%** të buxhetit të tyre për pagat e punonjësve.

sistemin e transfertavë, autonominë fiskale, transferimin e përgjegjësive dhe funskioneve dhe në ngërcin që ato krijojnë në qeverisjen vendore.

RDP/SDC & ADA e pasuron diskutimin në lidhje me nevojën për reformë territoriale dhe administrative, duke u fokusuar në rolin e nivelit të dytë të qeverisjes vendore, e duke analizuar thellësisht dhe duke paraqitur një studim për qeverisjen nën-kombëtare nga pikëpamja e qeverisjes në shumë nivele dhe e rajonalizimit.

SKL International & SHKSH / SIDA së fundmi i shtojnë diskutimit një tjetër studim, i cili bazuar në kontributet e studimeve paraardhëse, vjen me rekomandime për reformë administrativo-territoriale në nivelin e parë të qeverisjes.

Reforma Territoriale vis-à-vis Strategjia e Decentralizimit Fiskal

Në programin e saj "Shqipëria e Gjeneratës Tjetër", qeveria e re angazhohet të mbështesë decentralizimin e qeverisjes dhe fuqizimin e pushtetit vendor, në funksion të rritjes së efikasitetit të qeverisjes vendore, nëpërmjet zbatimit të reformës administrativo-territoriale dhe përmirësimit të procesit administrativ e fiskal.Reforma administrative territoriale nuk është qëllim në vetvete, por është një instrument për të përmirësuar qeverisjen, aksesin e plotë dhe cilësor të qytetarëve në shërbime publike, demokracinë lokale dhe zhvillimin ekonomik lokal. Për të arritur këto, reforma duhet të zhvillohet paralelisht në dy drejtime (**i**) konsolidim të territorit (bashkim të njësive vendore si në nivelin e parë – bashki/komuna dhe në nivelin e dytë - qarqet) dhe (**ii**) ndarje dhe qartësim i funksioneve dhe kompetencave midis niveleve të qeverisjes (thellim dhe konsolidim i decentralizimit).

Konsolidimi i njësive vendore është i domosdoshëm, pasi fragmentimi aktual i shërbimeve dhe burimeve natyrore rezulton jo efiçient. Legjislacioni aktual, parashikon bashkimin vullnetar mes njësive vendore si një mënyre për të adresuar efiçiencën dhe cilësinë e shërbimeve publike. Mirëpo, i lënë në mënyrë vullnetare, bashkimi nuk ka ndodhur. Përmes reformës territoriale, bashkimi mund të realizohet duke krijuar të gjitha hapësirat e mundshme, që zgjidhjet të vijnë nga poshtë lart.

> Megjithatë, ky ndryshim territorial nuk e zgjidh çështjen e kompetencave të Qarkut (si njësi e nivelit të dytë) në planifikim. Sërisht, edhe pas reformës, njësitë e nivelit të parë mund të vendosin të delegojnë në Qark kompetencën e planifikimit, por cili do të jetë funksioni i Qarkut në planifikimin e territorit, përtej delegimit?

Pavarësisht reformës territorial administrative "fizike", për të mundësuar që njësitë e reja të qeverisjes vendore të arrijnë efiçiencën dhe cilësinë e dëshiruar të shërbimeve, duhet të rishikohet strategjia e decentralizimit në përgjithësi dhe ajo e decentralizimit fiskal në veçanti. Pra cilësia dhe efiçienca varen sa nga madhësia fizike dhe funksionale e territoreve dhe nga numri i popullsisë, aq edhe nga lloji i funksionit, aftësia e niveleve qeverisëse të ndryshme për ta ofruar atë, politikat fiskale dhe sektoriale, etj. Pra, duhet të qartësohet çfarë shërbimesh ofrohen në secilin prej niveleve të qeverisjes, (veçanërisht në momentin e ndryshimit të madhësisë fizike), me çfarë standardi dhe si do të financohen. Vetëm duke e parë reformën me të gjithë këtë kompleksistet, do mund të modernizojmë qeverisjen, duke vendosur marrëdhënie të qarta *reciprociteti* midis zgjedhësve, qeverisjes lokale dhe asaj qendrore.

Mirëpo, ndryshimi i funksioneve ka ndikim të ndërsjellë si në reformën territoriale të nivelit të parë dhe të dytë të qeverisë vendore, ashtu edhe në politikat dhe legjislacionin sektorial dhe administrativ në përgjithësi. Le të marrim shembullin e planifikimit të territorit. Aktualisht, planifikimi urban (dhe jo i gjithë territorit), sipas përcaktimeve të ligjit për pushtetin vendor (8652/2000) është një nga funksionet e veta për autoritetet vendore të nivelit të parë. Deri më sot, bashkitë dhe komunat e vogla, në mjaft raste nuk kanë pasur kapacitete për ta ofruar si shërbim dhe e kanë deleguar në Qark. Krijimi i njësive vendore të mëdha në nivelin e parë, mendohet se do të përmirësojë mundësinë e autoriteteve vendore për ta ofruar vetë shërbimin (së paku do të plotësohet numri bazë i stafit). Megjithatë, ky ndryshim territorial nuk e zgjidh çështjen e kompetencave të Qarkut (si njësi e nivelit të dytë) në planifikim. Sërisht, edhe pas reformës, njësitë e nivelit të parë mund të vendosin të delegojnë në Qark kompetencën e planifikimit, por cili do të jetë funksioni i

Pabarazitë dhe zhvillimi rajonal

Të ardhurat e veta për frymë të njësive vendore,2008



Burimi: Ministria e Financave

% e të ardhurave të veta ndaj totalit, për njësi vendore



Burimi: Ministria e Financave 2011, Co-PLAN

Qarkut në planifikimin e territorit, përtej delegimit? Nëse Qarkut i jepet për shembull kompetenca për të përgatitur plane territoriale me natyrë strategjike për hapësirën administrative të tij, dhe këto plane konsiderohen si një kornizë detyruese për planet e nivelit të parë, do të thotë se në hierarkinë e planifikimit shtohet një hallkë e re (aktualisht nuk ekziston – së paku jo në formë detyruese). Pra legjislacioni i planifikimit duhet ta marrë në konsideratë. Gjithashtu, legjislacioni në planifikim duhet të konsiderojë që të mos ketë përplasje mes planit të qarkut (që nga natyra është plan rajonal për një territor administrativ vendor) dhe planit të integruar (që për nga natyra është plan rajonal për një rajon të papërcaktuar administrativisht, dhe kompetencë qendrore). Gjithashtu, madhësia dhe hapësira funksionale dhe natyrore që do të mbulojë Qarku (pas reformës administrative territoriale), duhet të jetë e tillë që të mos krijojë përplasje me hapësirat që janë objekt i planit të integruar.

Një analizë e shpejtë si më lart, na ndihmon të kuptojmë kompleksitetin e reformës administrative territoriale, përtej bashkimit fizik të njësive vendore. Sikurse u veprua për planifikimin, nevojitet të mendohet edhe për shërbime të tjera që mund të jenë objekt i rishikimit të raportit të kompetencave vendore/qendrore, në momentin e reformës. Funksione të tilla janë transporti urban ndërqytetas (rajonal/nivel Qarku), trajtimi i mbetjeve urbane, mbroja e burimeve natyrore, turizmi, shërbimi shëndetësor, arsimi profesional, zhvillimi rajonal, etj. Këto shërbime kanë nevojë për një qasje rajonale, që mbetet ende për t`u përcaktuar. Në këtë këndvështrim, ri-organizimi territorial në nivelin e dytë (nivel qarku) duhet të bëhet domosdoshmërisht i lidhur me qartësimin e kompetencave midis niveleve të qeverisjes dhe formës së përfaqësimit në nivelin e dytë. Pra cilësia e realizimit të kompetencës në nivelin e dytë varet nga autoriteti i institucionit dhe buxheti përkatës, që lidhen me autonominë e tij dhe legjitimitetin përpara zgjedhësve. Kjo kronologji na çon edhe më tej, në diskutime të ndryshimeve kushtetuese, apo të sistemit zgjedhor. Pra, pavarësisht se mund të mbajmë të njëtin emërtim "Qark", rishikimi i kompetencave/funksioneve të tij, ndryshimi i kufijve të njësive si në nivelin e parë, edhe të dytë, krijon një platformë shumë komplekse që kërkon edhe qasje dhe zgjidhje komplekse. E megjithatë, kjo platformë, sado e vështirë në dukje, mbetet domosdoshmëri, nëse synimi final (si shoqëri) është modernizimi i qeverisjes, dhe ofrimi i shërbimeve cilësorë për qytetarët.

Qasje të Mundshme për Rajonalizim (vijon nga fq.1)



Si mund të arrihet rajonalizimi - Qasja 2
Qasja e mundshme për rajonalizim ku kufinjtë 'rajon' të propozuar janë shënuar me ngjyrë të kuqe. Sipas kësaj qasjeje, ndarja është në 6 rajone, bazuar në basenet ujore të lumenjve kryesorë në Shqipëri, kufinjëve ekzistues të rrethit, akseve kryesorë të mobilitetit dhe krahinave historike.

Burimi: Co-PLAN



Si mund të arrihet rajonalizimi - Qasja 3
Qasja e mundshme për të arritur rajonalizim ku kufinjtë 'rajon' të propozuar janë shënuar me ngjyrë portokalli. Sipas kësaj qasjeje, ndarja është në 6 rajone, bazuar në këto kritere kryesore: aksesi dhe barrierat fizike, polet urbane, ndërveprimi ekonomik dhe social, dhe kufinjtë ekzistues të rrethit.

Burimi: Co-PLAN

Përmirësimi i Efiçencës së Energjisë në Sektorin e Banesave në Shqipëri



Universiteti POLIS, 12 Dhjetor 2013.

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, në bashkëpunim me Shoqatat Mjedisore Ekolëvizja, MilieuKontakt Albania dhe Qendra EDEN, organizoi një workshop kombëtar në kuadër të projektit të financuar nga BE "Zhvillimi i Platformës (ENV.net) në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi: t'i japim qytetarëve një zë për të ndikuar në procesin e reformave mjedisore për integrimin më të shpejtë në BE" dhe nëpërmjet Programit të Partneritetit për Organizatat e Shoqërisë Civile.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues te shumtë të shoqërise civile, të specializuar dhe të interesuar në çështjet e eficencës së energjisë në sektorin e banesave në Shqipëri, përfaqësues të lartë të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë,



Takimi kishte për qëllim:

1. Analizimin e progresit institucional dhe legjislativ deri në ditët e sotme, për efiçiencën e energjisë në sektorin e banesave në Shqipëri;
2. Prezantimim e rekomandimeve për të përmirësuar kuadrin aktual legjislativ dhe institucional për efiçiencën e energjisë në sektorin e banesave;
3. Rritjen e ndërgjegjësimit qytetar, shoqërisë civile dhe institucioneve mbi nevojën për progres në këtë fushë, dhe
4. Konsolidimin e rolit të shoqërisë civile në përmirësimin e kuadrit ligjor për efiçiencën e energjisë dhe lehtësimin e zbatimit të tij.

të Delegacionit të Komisionit Evropian në Tiranë, të Programit te Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, të Bankës Botërore, etj.

Pjesëmarrësit u njohën fillimisht me pozicionin e Komisionit Evropian në çështjet e efiçencës energjitike në tërësi. Përfaqësuesi i Delegacionit të Komisionit Evropian në Tiranë, Z. Fracois BEGEOT theksoi nevojën që Shqipëria dhe vendet e tjera në rajon për të vazhduar promovimin e eficiencës së energjisë për të arritur objektivin 20% deri në vitin 2020, si dhe njëkohësisht për të promovuar më shumë burimet e brendshme energjitike. Ai nënvizoi nevojën për një treg të brendshëm sa më efektiv, për burime financiare dhe më shumë investime për efiçencën energjitike, infrastrukturën e transmetimit dhe prodhimin e energjive të rinovueshme.

Co-PLAN parashtroi një analizë të kuadrit ligjor dhe institucional për efiçencën e energjisë në sektorin e banesave si dhe te mangësive institucionale dhe ligjore që duhen plotësuar në vijim për të rritur efiçencën në përputhje me objektivat kombëtare.

Më pas u paraqitën nga Milieukontakt Albania rezultatet e anketimit mbi njohjen dhe kërkesën e qytetarit shqiptar per efiçencën energjitike në raport me termoizolimin e banesave, sistemet e ndriçimit dhe të ngrohje-ftohjes dhe përdorimit të pajisjeve elektroshtepiake qe konsumojnë më pak energji. Prezantimet vijuan me Qendrën Eden e cila parashtroi një model të përllogaritjes së efiçencës energjitike, model i cili pritet të kontribuojë tek institucionet shqiptare në përllogaritjen e efiçencës energjitike në banesa si dhe në përcaktimin e masave të duhura në përmbushje të objektivave kombëtare.

Banka Procredit Albania paraqiti politikat mjedisore të kësaj banke në funksion të kreditimit te butë të qytetareve/ bizneseve apo institucioneve shtetërore që kërkojnë të rrisin efiçencën energjitike në banesa.

Me rëndësi ishte parashtrimi i qasjes së Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë mbi qasjen dhe hapat që do të ndërmerren nga politikë-bërësi shqiptar për transpozimin e Direktivës së Eficencës së Energjisë me anë të Kodit Energjitik.

Në përfundim të prezantimeve nga organizatat, ministria, dhe sektori privat, u kalua në diskutim intensiv mbi çështjet e ngritura gjatë pjesës së parë të workshopit, konkluzionet e gjetjet e të cilit janë përmbledhur në shtatë rekomandime kryesore.

Konkluzionet e Takimit Kombëtar për Përmiresimin e Efiçencës së Energjisë në Sektorin e Banesave në Shqipëri:

1. Kuadri ligjor për Efiçencën Energjitike duhet të përditësohet në përputhje me Direktivën e fundit të BE-së për eficiencën e energjisë. Ai duhet domosdoshmërisht të përmirësohet edhe nëpërmjet miratimit sa më të shpejtë të akteve nënligjore që do të bëjnë të mundur zbatimin në praktikë të ligjit e sidomos për çështjet e metodologjisë për llogaritjen e efiçiencës së energjisë, për trupat çertifikues dhe auditues energjitikë si dhe incentivat financiare. Ministria e Energjisë dhe Industrisë si dhe institucionet e tjera politikë-bërëse duhet të propozojnë dhe të miratojnë politika fiskale zbatuese për të bërë sa më tërheqëse për konsumatorin ndërmarrjen e masave/ investimeve për efiçencën energjitike. I gjithë ky kuadër ligjor dhe nënligjor duhet të këshillohet paraprakisht me të gjitha palët e interesit e sidomos me shoqërinë civile për nxitje të eficencës energjitike në banesa dhe më gjerë.
2. Politikë-bërësit duhet të ndërtojnë në mënyrë te ngutshme një sistem funksional të njohjes nëpërmjet matjeve të performancës energjitike të stokut tonë të banesave për të vendosur çfarëdolloj objektivash konkrete për të ardhme.
3. Mbështetja e përpjekjeve në përmbushje të objektivave kombëtare për efiçencë energjitike në banesa kërkon domosdoshmërisht krijimin e një Fondi për Eficiencën e Energjisë sikurse parashikohet në le-









Sistemi i eficiencës energjitike ka nevojë për kapacitete njerëzore, profesionale apo të nivelit të lartë, të formuara në vend apo jashtë tij për të përmbushur nevojat e institucioneve qendrore dhe vendore si dhe të enteve publike dhe private. Institucionet arsimore të vendit kanë sot kurrikula mësimore të dedikuara për eficencën energjitike në banesa dhe me gjerë. Ndërkaq institucionet politikë-bërëse dhe zbatuese duhet të parashtrojnë kërkesat e tyre për kapacitete njerëzore të dedikuara, të njohin programet arsimore të krijuara dhe t'i përdorin ato për formimin apo çertifikimin e ekspertizës në fushën e eficiencës energjitike në banesa dhe në sektorë të tjerë.

gjislacionin e sotëm dhe draft-ligjin e hartuar në këtë fushë. Pjesëmarrësit mbështetën idenë e bashkëpunimit midis Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë për krijimin e një Fondi të përbashkët për Mjedisin dhe Efiçiencën e Energjisë sikurse dhe në vendet e tjera të rajonit ballkanik. Krijimi i kësaj strukture do të përfitojë nga puna parapërgatitore ligjore, institucionale dhe financiare e zhvilluar deri më sot nga institucione vendase dhe të huaja. Krijimi i Fondit të Mjedisit dhe Eficencës së Energjisë do të reduktonte kështu numrin e fondeve të krijuara, do të nxiste thithjen e më shumë fondeve të huaja dhe të brendshme dhe do të kordinojë me mirë të gjitha përpjekjet e institucioneve të ndryshme, qeveritare dhe jo-qeveritare, të vendit dhe të huaja, për efiçencë energjitike në përgjithësi e sidomos në sektorin e banesave.

4 Elementët e efiçiencës së energjisë duhet të integrohen domosdoshmërisht në kodin e ndërtimit për të përfshirë efiçencën energjitike që në themel të mënyrës sesi ne projektojmë dhe ndërtojmë. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, si institucioni kryesor propozues dhe zbatues i Kodit te Ndërtimit duhet të trajtojë me përparësi çeshtjet e eficencës energjitike në banesa. Për më shumë nevojitet vendosja e rregullave të ndërtimit që respektojnë performancën energjitike të banesave. Eficenca e energjisë duhet të shikohet si përgjegjësi ndër-sektoriale me përfshirjen edhe të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit krahas Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Ministrisë së Mjedisit.

5 Sistemi i efiçiencës energjitike ka nevojë për kapacitete njerëzore, profesionale apo të nivelit të lartë, të formuara në vend apo jashtë tij për të përmbushur nevojat e institucioneve qendrore dhe vendore si dhe të enteve publike dhe private. Institucionet arsimore të vendit kanë sot kurrikula mësimore të dedikuara për efiçencën energjitike në banesa dhe me gjerë. Ndërkaq institucionet politikë-bërëse dhe zbatuese duhet të parashtrojnë kërkesat e tyre për kapacitete njerëzore të dedikuara, të njohin programet arsimore të krijuara dhe t'i përdorin ato për formimin e çertifikimin e ekspertizës në fushën e efiçiencës energjitike.

6 Institucionet shtetërore duhet të integrojnë dhe koordinojnë planet dhe projektet e tyre me shoqërinë civile, për të përfituar nga eksperienca e shoqërisë civile dhe nga ndikimi i saj i gjerë në komunitet.

7 Shoqëria civile duhet të krijojë një aleancë të saj për më shumë ndikim ndaj autoriteteve shtetërore për masat dhe përgjegjësitë që duhet të marrin në zbatim dhe përmbushje të objektivave strategjikë dhe kuadrit ligjor. Gjithashtu, aleanca duhet të përdoret për të ndarë me partnerët projektet dhe programet e zhvilluara, për të promovuar eficencën energjitike tek publiku si dhe për të nxitur reagimin e tij civil.









Mësime të vlefshme mbi *Artin Urban* si mjet për ndryshim

Ashtu si dhe arti, një qytet mund të jetë e të ofrojë shumë gjëra njëherësh. Në sytë e atij që e sheh, një qytet mund të jetë një vend-banim, apo një eksperiencë; një qytet mund të jetë tërësia e shërbimetve bazë të pritshme, një djep kulture, trashëgimie historike apo dhe një vend arti. Një qytet mund të jetë edhe, një ndjesi e përjetim personal!



Ashtu si dhe shumica e qyteteve nëpër botë edhe qytetet shqiptare kanë pësuar ndryshime të thella për shkak të urbanizimit të shpejtë, nevojave në rritje dhe kërkesave për shërbime, të cilat kanë sjellë dhe ndryshime në kontekstet socio-politike. Këto ndryshime kanë të bëjnë me vlerat sociale, dhe mënyrën si qytetarët sillen dhe ndërveprojnë me qytetin. Rritja e vendbanimeve informale në shumicën e qyteteve të Shqipërisë, si Tirana, Durrësi, dhe bregdeti, ka bërë që një pjesë e rëndësishme e zhvillimit urban të udhëheqet nga një sjellje individualiste e shfaqur në forma të panumërta, në ngjyra, dhe stile, përpjekje dhe aneksime të hapësirave publike. Në disa raste, individët duke pasur guximin të eksperimentojnë me artin, përfshinë në to zgjidhje individuale që i përshtaten zonës.

Pa u kushtëzuar nga ky art disi *i diskutueshëm dhe kaosit të betonuar,* një tipar është i përbashkët për të gjithë këto zhvillime, si në rastin e Tiranës, Beogradit, Shkupit, apo dhe Prishtinës. Bëhet fjalë për një dëshmi të prekshme të përdorimit të energjisë njerëzore në menyrë të padrejtuar dhe të paplanifikuar. Kështu, gjatë 20 viteve të fundit dhe me më shumë se 140 projekte dhe partneritete, ne kemi mësuar shumë për komunitetin, për hapësirat publike, për atë/ato çka e bëjnë një qytetet, dhe se si arti mund të shërbejë si një recetë për sukses.

Art dhe Kulturë për përmirësimin e kohezionit social

Festivale, pjesë teatrale apo aktivitete të ndryshmë të komunitetit, si dhe ngjarje të tjera publike kanë treguar se si aktivitetet kulturore mund të sjellin njerëzit së bashku. Në rastet kur kohezioni social ka qenë i ngadaltë në arritjen e urbanizimit të shpejtë, ***Arti & ngjarjet kulturore*** janë përdorur rregullisht për të inkurajuar njerëzit për të kapërcyer pengesat që burojnë nga dallimet, sepse arti është kuptimplotë dhe ai mund të "gjallërojë" dialogun midis njerëzve dhe grupeve sociale.

Art me pjesëmarje!

Në qoftë se ne duam që qytetet të ofrojnë diçka për të gjithë, është e rëndësishme që të angazhohen njerëz në proceset e qytet-bërjes. Qytetet duhet të jenë të dizenjuara në mënyrë të tillë që të adresojnë nevojat e njerëzve, dhe t'i

përgjigjen problematikave lokale.

Ashtu si Jane Jacobs e thoshte aq bukur: “Nuk ka logjikë që mund të imponohet një qyteti; njerëzit e bejnë qytetin, dhe është rreth njerëzve dhe jo rreth godinave që duhen hartuar planet“.

Arti në hapësirat publike për të eksploruar identitetet

Arti bazuar në aktivitete dhe ngjarje është përdorur nga komunitetet e të gjitha llojeve për shqyrtimin dhe afirmimin e identitetit të tyre, veçanërisht në vendet në tranzicion, ku ndryshimet e shpejta social-politike mund të kenë implikime në mënyrën se si një qytet përcjell apo rishpik vetëveten.

Arti për të përmirësuar imazhin lokal

Arti dhe kultura mund të ofrojnë një lente alternative për të parë një qytet. Nëpërmjet ngjarjeve ndërkombëtare, të tilla si Javët e Arkitekturës në Tiranë, të është bërë i mundur promovimi i një imazhi që shkon përtej problemeve të lidhura me një qytet të caktuar, duke u përqëndruar më shumë në aspektet pozitive të tilla si vlerat , dhe perspektiva për rritje.



Art me kosto të përballueshme

Për të siguruar që aktivitete të tilla të jenë të arritshme nga komuniteti, harto aktivitete të qasshme për komunitetin. Mbajtja e tyre me kosto të ulët mund të inkurajojë pjesëmarrjen. Një gjë interesante, formë e përdorur gjithnjë e më shumë është aktivizmi urban në formën e artit të rrugës, apo të ndërhyrjeve të vogla ndikuese, në pjesë të ndryshme të qytetit në varësi të temave.



Mësoni nga pararendësit!



Ka ide të panumërta, projekte dhe praktika të zbatuara në pjesë të ndryshme të botës, kur është fjala për hapësirën publike dhe ndërtimin e qytetit, aq shumë saqë është e vështirë për të dalë me një ide krejtësisht të re. Ndaj është e rëndësishme të shihen përvojat e shkuara, dhe të mësohet nga gabimet e tyre, apo mësimet e nxjerra. Edhe pse idetë janë tërheqëse, nuk ka përse të rishpiket rrota për të ndikuar, apo për të shkaktuar një ndryshim pozitiv në shoqëri.

Shembuj shumë të mirë të këtij arti urban janë **Javët e Arkitekturës në Tiranë** (2012), dhe **Javët e Dizajnit në Tiranë** (2013), të cilat shërbejnë si platforma për të lëshuar dhe këmbyer përvoja të tilla, dhe ushqejnë mendimin krijues kur është fjala për rolin e artit, design, e *di-qysh* dhe komunitetet mund të luajnë në formësimin e hapësirës publike dhe duke kontribuar në qytet-bërjen.



POLIS IKZH - Publikime



Projektim me natyrën
nga Ian McHarg

Libri i Ian McHarg *Projektim me Natyrën* krijoi konceptin e planifikimit ekologjik i cili që prej vitit 1969 vazhdon të jetë një nga librat më të njohur gjerësisht në arkitekturën e mjedisit dhe planifikimit të përdorimit të tokës. Në këtë libër, McHarg prezantoi konceptet themelore që u zhvilluan më vonë në Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS). Ky libër është veçanërisht i vlefshëm për ekspertët e planifikimit, për arkitektët dhe ekspertët e mjedisit, veçanërisht e rëndësishme për sfidën kombëtare të planifikimit të territorit e cila ballafaqohet me mungesën e marjes në konsideratë të natyrës në procesin e planifikimit. Faktikisht, *Projektim me Natyrën* ishte i pari punim i këtij lloji i cili "përcaktoi problemet e zhvillimit modern duke parashtruar një metodologji apo proçes për zgjidhje të pajtueshme".

McHarg promovoi një pikëpamje ekologjike, në të cilën projektuesi njihet shumë mirë me zonën nëpërmjet analizës së tokës, klimës, hidrologjisë, etj. Libri gjithashtu pati ndikim në disa fusha të ndryshme dhe në ide, të tilla si: "Vlerësimi i ndikimit në mjedis, zhvillimi i ri komunitar, manaxhimi i zonës bregdetare, restaurimi i zonave ish-industriale, projektimi i kopshteve zoologjike, planifikimi i korridoreve të lumenjve, dhe idetë rigjeneruese për qëndrueshmëri dhe projektim, të gjitha shfaqin ndikimin e tyre në projektim me natyrën.

Vlerësimi Strategjik mjedisor në planifikimin e transportit dhe përdorimin e tokës
nga Thomas B. Fischer



Zhvillimi i shpejtë urban në Shqipëri ka pasur pasoja e kosto të mëdha për mjedisin dhe burimet natyrore. Ndaj dhe vlerësimi i plotë i shkallës së këtyre ndikimeve është thelbësor për planifikimin efektiv të transportit dhe të përdorimit të tokës. Libri i Thomas Fisher ofron një analizë të qartë të planifikimit të transportit dhe përdorimit të tokës duke përdorur *Vlerësimin Strategjik Mjedisor* (VSM). Ai përcakton efektivitetin e VSM-së përmes studimeve krahasimore të praktikës në tre vende: Britani e Madhe, Hollandë dhe Gjermani. Autori tregon se përdorimi i VSM-së është i përhapur, por ende larg nga përdorimi sistematik. Ai tregon avantazhet e aplikimit në përdorim sistematik të një forme të plotë të VSM-së realizuara nga të gjitha qasjet e mëdha aktuale.

Ky publikim do t'u vijë në ndihmë ekspertëve mjedisorë, autoriteteve të qeverisjes vendore, politikëbërësve, studentëve, e më gjerë, nëpërmjet koncepteve, praktikave dhe analizave të detajuara të gjetjeve empirike të punës kërkimore.



Qyteti Troç (Comics)

Për ëndërrimtarët e qyteteve
Qyteti, vendi ku lindin ëndrrat, rriten fëmijët, dhe krijohen kultura.
Vendi ku ndodhin përplasjet dhe formëzohen ndryshimet.
Vendosen rregullat dhe thyhen status quo-të.
Vendi ku projektojmë të ardhmen, dhe tjetërsojmë hapësirat.
Qyteti: vendi i plotësimit të nevojave apo i ofrimit të mundësive

Si qytetarë ne e përjetojmë qytetin në mënyra të ndryshme, e megjithatë, thuajse të gjithë e marim në mënyrë të pashmangshme atë dozë absurdi, humori e sfide si pjesë e jetës së përditshme në qytet. Qyteti Troç përcjell pikërisht këtë ndjesi të përjetimeve individuale të secilit prej nesh, të cilat të mara së bashku formëzojnë qytetin si një i terë.

Përmes katër situatave të ndryshmë të shkëputura nga realiteti i qytetit shqiptar, ose të lidhura ngushtësisht me të, Qyteti Troç portretizon qytetin kaotik, ku energjia është shpesh herë informale dhe e betonuar, në forma e ngjyra të shumëllojta, ku gjithësecili përpiqet ta bëje të tijin qytetin. Përmers një numri personazhesh përfaqësues, dhe skicave origjinale, Qyteti Troç përpiqet të rrisë ndjeshmërinë e njerëzve ndaj një sërë ndodhish apo fenomenesh që kalojnë pa u vënë rë sepse mund të jemi lodhur prej tyre, apo sepse nuk kemi provuar t'i kuptojmë e zgjidhim mjaftueshëm.

Platforma online e të "njohurit në pëllëmbë të dorës"

Ne besojmë se një demokraci e shëndoshë ndërtohet mbi qytetarët e saj dhe sistemin e saj të vlerave, e cila është arsyeja pse ne e konsiderojmë qasjen të përmirësuar në informata dhe ndërgjegjësimin publik në rritje lidhur me çështjet lokale të qeverisjes, si ankesat prioritare për veprim.

Për këtë qëllim Universitetit POLIS dhe Co-PLAN propozojnë një projekt të projektuar në një mënyrë tërheqëse dhe me vlera të prekshme praktike për komunitetin dhe autoritetet e tij qeverisëse. Ne planifikojmë të krijojmë një platform falas online të njohurive mbi një numër çështjesh dhe aspektesh që lidhen me qeverisjen, mjedisin, planifikimin, financave publike, etj



Financat publike në zhvillim dhe vendet në tranzicion:

Ese në nder të Richard Bird (Studime në federalizmin fiskal dhe Financat qendore dhe vendore) - nga Richard Miller Bird dhe James Alms

Është e vështirë të gjesh dikë që ka kontribuar kaq shumë dhe kaq gjerësisht në hulumtime të ndryshme në financat publike ndërkombëtare që nga viti 1960, ashtu si Richard Bird. Ky vëllim esesh lindi nga një konferencë në nder të tij dhe zgjeron të kuptuarit tonë të fushës së financave publike ndërkombëare.

Financat përbëjnë një element të pandashëm të zhvillimit urban, veçanërisht në vendet në tranzicion dhe në zhvillim, sikurse është rasti i Shqipërisë. Ky publikim do t'u vijë në ndihmë ekonomistëve, politikëbërësve, studentëve, e më gjerë, nëpërmjet koncepteve, praktikave dhe qasjeve të vendeve të ndryshme në fushat e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare, politikave fiskale dhe evazionit fiskal si dhe administratave tatimore. Të tilla trajtesa janë veçanërisht të rëndësishme duke pasur parasysh proçeset e vazhdueshme të decentralizimit fiskal në Shqipëri.

Planifikimi gjithë përfshirës

Literatura në planifikimin pjesëmarrës është konsoliduar gjatë këtyre 20 viteve të fundit dhe është një burim i shkëlqyer i informacionit shkencor dhe praktik për profesionistët dhe vendimmarrësit. Megjithatë, gjetja e një libri i cili ngrihet në kontekstin dhe përvojën lokale, mbetet një sfidë. Një libër i tillë mungon në Shqipëri, ndërkohë që përvoja e përfshirjes në planifikimin hapësinor dhe në qytet daton mbi 15 vjet më parë. Kjo përvojë e vlefshme, si dhe e autoriteteve lokale që punojnë në bazë të këtyre njohurive, nuk është përdorur në mënyrë efikase dhe ende nuk është shpërndarë plotësisht në mesin e të gjitha segmenteve të shoqërisë dhe të institucioneve publike dhe private. Manuali i Planifikimit gjithë përfshirës është një iniciativë e mbështetur nga USAID, si pjesë e projektit të PLGP-së.

USAID | SHQIPËRI





Forum A + P No.12

Ky periodik shkencor, botim i Universitetit POLIS, dokumenton ngjarjet më të fundit në Arkitekturë dhe Dizajn në Javën e Arkitekturës 2012. Qëllimi i Javës së Arkitekturës, një ngjarje që përsëritet çdo dy vite, është që të promovojë shkëmbimin ndërkombëtar të njohurive në mesin e profesionistëve dhe të rrisë interesin e publikut në arkitekturë, art dhe dizajn, si disiplina thellësisht të fokusuara me shqetësimet e zhvillimit bashkëkohor urban. Qytetet e Ballkanit kanë kaluar nëpër ndryshime radikale sociale dhe ekonomike, që rezultojnë në zhvillime të ndryshme dhe shpesh të pakontrollueshme.



www.co-plan.org

KNOW HOW

Një platformë njohurish praktike e të thjeshta për çdo qytetar apo autoritet.



TAW

TIRANA ARCHITECTURE WEEK

2014

COMING SOON

Javët e Arkitekturës në Tiranë organizohen nga Unversitetit POLIS, Co-PLAN, dhe Bashkia e Tiranës mbështetur nga një rrjet i gjerë partnerësh lokalë dhe ndërkombëtarë. Qëllimi i Javëve të Arkitekturës në Tiranë (JAT) është të promovojë shkëmbim ndërkombëtar të njohurive ndërmjet profesionistëve, si dhe të forcojë interesin e publikut në arkitekturë, art e dizajn, si disiplina thellësisht të lidhura me zhvillimin e qytetit bashkëkohor, duke shërbyer si një platformë, ku pjesëmarrës vendas e të huaj ndajnë mes tyre njohuri të dobishme e avangard, tek sa eksperienca ballkanike rrezaton 'ushqim për mendim' unik e frymëzues. Për një program më të detajuar na ndiqni në:

www.tiranaarchitectureweek.com